



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-054
Prishtinë, më 19 shkurt 2016, ora 19:00

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 SHKURT 2016, ora 19:00

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës, të caktuar me vendim të seancës plenare të datës 19 shkurt 2016, të mbajtur në orën 10:00.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 72 deputetë.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068.

Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime.

Më pas, Kuvendi miratoi amendamentet nr.: 1, 2 dhe 3.

Në lidhje me amendamentin nr. 3 diskutuan deputetët: Alma Lama, Armend Zemaj, Melihate Tërmkolli, Raif Qela, Arben Gashi, Hajdar Beqa dhe Naser Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 19:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi: Selman Ymeri,
zyrtar i lartë ligjor*